



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 834/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Izmi Zeka kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Gjilan, kundër komisionerve dhe kryesuesit të QVV për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Izmi Zeka kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Gjilan.

Arsyetim

Me datën 12.11.2013, Izmi Zeka kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Gjilan, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se ka pasur pa rregullsi në procesin e numërimit të votave në 40 kutitë e QV në Gjilan, të cilat janë të dyshimta për manipulim. Këto kuti sipas parashtruesit të ankesës janë dërguar në karantinë në QNR, andaj kërkoj nga PZAP-i që të bej hapjen e kutisë së votimit për manipulimin e votave, thuhet në pretendimet e ankuesit

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund të rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e Izmi Zeka kryetar i Degës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) nuk qëndrojnë ngase nuk ka bashkangjitur asnjë provë bindse me të cilën mund të vërtetohen pretendimet ankimore. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante dhe se duke i nisur nga fakti se QNR është ende në procesimin dhe numërimin e votave rezultati përfundimtar mund të ndryshoj, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 834/2013 më datën 12.11.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.